

## **Vendim nr. 167, datë 22.05.2026**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Sandër Beci,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 22.05.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (H) 2026 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** HASAN ROQI

**OBJEKTI:** Njoftimi i kërkuarit për përbërjen e Kolegjit të Shqyrtimit paraprak të Gjykatës Kushtetuese nga shorti në këtë çështje, përpara se të fillojë shqyrtimi i saj.

Shpallja antikushtetuese në seancë plenare e njoftimit për përfundimin e hetimeve të procedimit penal nr. 2307, datë 19.11.2021 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan; vendimeve nr. 1199, datë 26.07.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; nr. 10-2021-2367 (400) të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2025-811, datë 22.05.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, të cilat kanë pranuar dhe ligjëruar dhunimin e vendimit nr. 2227, datë 08.10.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë, lënë në fuqi nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 489, datë 26.03.1998; dhunimin e ligjit të kohës, UKM-së, nr. 3, datë 21.06.1993; dhunimin e vendimit nr. 54, datë 25.01.2001 të Gjykatës së Apelit Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 1187, datë 05.11.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nga personat e interesuar, nga prokurori dhe vetë gjykatat e ligjit.

Vendimet e mësipërme vijnë pas serialit të vendimeve për të njëjtën çështje, me burim nga gjykatat e ligjit, të kërkesave të kërkesit Hasan Roqi, kundër tyre në Gjykatën Kushtetuese, e cila ka dhënë vendimet si vijon: nr. 76/2000; nr. 16/2016; nr. 86/2021; nr. 86/1/2021; nr. 111/2021; nr. 177/2022; nr. 119/2023; nr. 224/2023; nr. 20/2023; nr. 35/2023; nr. 36/2023; nr. 37/2023; nr. 2/2023; nr. 138/2023; nr. 231/2023; nr. 32/2023; nr. 38/2023; nr. 38/1/2023; nr. 38/2/2023; nr. 31/2024; nr. 32/2024; nr. 305/2024; nr. 159/2025; nr. 196/2025; nr. 197/2025; nr. 288/2025; nr. 316/2025; nr. 322/2025. Nuk është në kompetencën e kërkesit të bindë organizmat kombëtarë e ndërkombëtarë, se nuk kemi para një puçi ndaj Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ndaj Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndaj praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndaj Gjykatës Ndërkombëtare Penale, për rastin e gjenocidit dhe krimit kundër njerëzimit, mbi kërkesin dhe 4154 familjet e tjera, të grabitura nga autoritetet e mbrojtura nga gjykatat e të gjitha niveleve. Në një sistem diktatorial, ku shkatërrohet jeta e familjes së kërkesit, me grabitje, dhunë fizike, psikologjike e juridike, në shpërdorim të detyrës, dhunohet shteti i ligjit, ku lulëzon korrupsioni dhe krimi i organizuar, mbrojtur me veprime e vendime gjyqësore, me të cilat shprehet qartë domethënia e vullnetit të tyre faktik, në kërkimin e largimit të aderimit të Republikës së Shqipërisë nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. As që bëhet fjalë për t'u bërë anëtar i Bashkimit Evropian kundrejt një shteti të ligjit. Një vendim i tillë abrogimi nuk i takon pushtetit gjyqësor, por Kuvendit të Shqipërisë.

Të drejtat e fituara me ligjin e kohës, UKM-së nr. 3, datë 21.06.1993, me vendimin përfundimtar nr. 2227, datë 08.10.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 76/2000 të Gjykatës Kushtetuese, janë të patjetërsueshme, të pazëvendësueshme nga asnjë vendim

tjetër, ose ligj të shkatërruara plotësisht si nga ana juridike, ashtu edhe nga ana fizike me ndërhyrjen e autoriteteve, nga gjykatat dhe terren, me krim të organizuar dhe korrupsion, si rrjedhim kërkohet rehabilitimi dhe zhdëmtimi i drejtë, material dhe moral i kërkuesit dhe familjes së tij.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 4, pikat 2 dhe 3, 5, 7, 11, pika 2, 15, pikat 1 dhe 2, 17, pikat 1 dhe 2, 18, pikat 1, 2 dhe 3, 25, 37, pika 1, 41, pikat 1 dhe 2, 42, pikat 1 dhe 2, 44, 81, pika 2, shkronjat “a” dhe “d”, 100, pikat 4 dhe 5, 107, pika 1, 116, pika 1, shkronjat “a”, “c” dhe “ç”, 117, pika 1, 118, pikat 1 dhe 2, 122, pika 2, 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, 141, pikat 1 dhe 2, 142, pikat 1 dhe 3, 145, pikat 1 dhe 2, si dhe 148/d, pikat 1 dhe 2, shkronja “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, pika 1, 8, pika 1, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*), si dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; nenet 1, pika 2, 26, pikat 1 dhe 2, 27, pikat 1, 2 dhe 3, 36, 37, 39, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, 43/b, pikat 1 dhe 2, 48, pikat 1 dhe 2, 49, pikat 3, shkronja “e”, dhe 4, 50, pika 4, 71, 71/a, pikat 1 dhe 3, 81, pikat 1, 2, 3 dhe 4, si dhe 86 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## **V Ë R E N:**

### **I**

#### **Rrethanat e çështjes**

1. Rasti i kërkuesit lidhet me mosmarrëveshjen që ai ka pasur me një banesë shtetërore dykatëshe, të ndodhur në Tiranë, e cila është bërë objekt edhe i proceseve gjyqësore të zhvilluara nga gjykatat e zakonshme. Po kështu, rezulton se në lidhje me këtë pronë dhe

proceset gjyqësore të zhvilluara për të, kërkuesi i është drejtuar disa herë Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual.

2. Ndërkohë, referuar rastit, objekt i këtij ankimi kushtetues individual, rezulton se kërkuesi ka bërë kallëzim penal ndaj shtetasve E.K., ish-nënkryetar i minibashkisë nr. 10, Tiranë, G.Xh., dhe A.G., të cilët në kohën e paraqitjes së kallëzimit ushtronin detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Sipas kallëzimit të kërkuesit, shtetasi E.K., gjatë ushtrimit të detyrës, ka urdhëruar shkatërrimin e pronës së tij, duke kryer njëkohësisht veprime arbitrare me shkresa, të cilat shkelin ligjin e shtetit dhe vendimet e formës së prerë të gjykatave. Më pas, në kallëzimin e tij, kërkuesi ka pretenduar se këto veprime janë mbrojtur nga prokurorët e çështjes, të cilët kanë hetuar mbi kallëzimet e tij të bëra pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Pas sqarimit të kompetencës lëndore për këtë kallëzim, ai është regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Kjo e fundit, në përfundim të hetimit, ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan kërkesën, me objekt pushimin e procedimit penal nr. 2307/2019, regjistruar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal (KP), me arsyetimin se fakti i kallëzuar nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 1199, datë 26.07.2021, ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. 2307/2019, regjistruar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i KP-së, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Sipas asaj gjykate, në rastin objekt hetimi, organi procedues me të drejtë ka arritur në përfundimin e mungesës së elementeve të veprës penale të shpërdorimit të detyrës, pasi nuk konstatohet se nga shtetasi E.K. të jenë kryer veprime në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, në kundërshtim me ligjin që të kenë sjellë pasojën në cenim të interesave të ligjshëm të kallëzuesit. Po kështu, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se veprimet e shtetasit E.K. janë kryer në referim të dispozitave ligjore që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e organeve të qeverisjes vendore dhe janë kryer në përmbushje të ushtrimit të detyrave të tij funksionale administrative, rrjedhimisht mungon konsumimi i elementeve të veprës penale, të parashikuar nga neni 248 i KP-së. Për këto arsye, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se referimi ligjor që i bën prokurori, arsyeve ligjore dhe referimit të dispozitave procedurale përkatëse, për të cilat kërkon pushimin e procedimit penal është i saktë dhe i drejtë, dhe mungesa e elementeve të një figure konkrete penale, ashtu siç ka rezultuar në rastin objekt hetimi, çon në përfundimin se fakti nuk parashikohet nga ligji në interpretim të neneve 328, pika 1, shkronja “b”, dhe 329/b, pika 3, të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe çështja duhet të pushohet. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë ka bërë ankim kërkuesi.

4. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2021-2367 (400), datë 22.12.2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 1199, datë 26.07.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Sipas gjykatës së apelit, në analizë të fakteve dhe të provave të shqyrtuara në seancë gjyqësore, parë në raport edhe me dispozitat ligjore penale e procedurale që gjejnë zbatim në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka arritur në përfundimin se duhet të vendoset pushimi i çështjes penale nr. 2307 i vitit 2019, regjistruar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i KP-së, për shkak se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Për sa i përket zgjidhjes në themel të çështjes, gjykata e apelit ka vlerësuar se, ndryshe nga sa pretendon kallëzuesi, në rastin konkret, fakti i kallëzuar prej tij kundër veprimeve ose mosveprimeve të shtetasit E.K. nuk përbën elementet e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i KP-së. Po kështu, gjykata e apelit ka arsyetuar se nga shqyrtimi në tërësi i akteve që i përkasin këtij procedimi penal, rezulton se nga ana e shtetasit E.K., në cilësinë e nënkryetarit të minibashkisë nr. 10, Tiranë nuk është kryer ndonjë veprim ose mosveprim në kundërshtim me detyrën e tij. Për më tepër, sipas gjykatës së apelit, në rastin konkret jemi para institutit të parashkrimit të ndjekjes penale, bazuar në nenin 66, shkronja “c”, të KP-së, pasi që nga momenti i kryerjes së veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i KP-së, datë 03.09.2009 (referuar datës që mban shkresa nr.1633) dhe deri në momentin e shqyrtimit të kësaj kërkesë, kanë kaluar mbi 12 vjet. Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka paraqitur rekurs kërkuesi.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-811, datë 22.05.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit, për shkak se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 432 të KPP-së. Sipas Kolegjit Penal, gjykatat më të ulëta kanë argumentuar mjaftueshëm vendimmarrjen e tyre, ndërkohë që pretendimet e kallëzuesit fokusohen në rrethanat e faktit dhe arsyet e parashkrimit të kallëzimit penal. Nga ana tjetër, në vlerësimin e Kolegjit Penal vendimmarrja e gjykatës së apelit është e mirarsyetuar, duke marrë në analizë dhe shqyrtim në mënyrë ezauruese të gjitha pretendimet e parashtruara nga kallëzuesi. Po kështu, Kolegji Penal ka arsyetuar se nuk konstatohen shkelje të Kushtetutës ose neneve të KEDNJ-së.

6. Në datën 09.03.2026 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), i cili është regjistruar në të njëjtën datë.

## II

### Pretendimet e kërkuetit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

- 7.1. *Parimi i sigurisë juridike*, pasi vendimi nr. 2227, datë 08.10.1997 i Gjykatës së Apelit Tiranë, për të cilin është nxjerrë urdhri i ekzekutimit nr. 2024 akti, datë 22.11.2007 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka mbetur i pa ekzekutuar, për shkak të ndërhyrjes në organet ekzekutive dhe në gjykata të ish-Kryeministrit dhe ish-ministrit të Drejtësisë. Nën ndikimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar u lëshua një certifikatë e paligjshme nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, e cila shërbeu si Kushtetutë, duke mposhtur vendimin e formës së prerë nr. 2227, datë 08.10.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe duke nxjerrë nga banesa kërkuesin dhe familjen e tij. Vendimet e mëparshme të dhëna nga Kolegjet e Gjykatës janë pjesë e dhunimit të vendimit nr. 2227, datë 08.10.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë.
- 7.2. *Parimi i paanshmërisë*, pasi gjyqtari M.B. që ka qenë pjesë e Kolegjit Penal që ka shqyrtuar rekursin e kërkuesit kundër vendimit të gjykatës së apelit, e cila ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pranimin e kërkesës së organit të akuzës për pushimin e procedimit penal, është akuzuar nga kërkuesi si pjesë e grupit të strukturuar kriminal. Ky parim është cenuar edhe nga gjyqtarja tjetër e Kolegjit Penal, A.B., pasi ajo ka mbajtur qëndrim me dy standarde dhe lejoi të cenoheshin në këtë çështje dy vendime të Gjykatës së Lartë, pasqyruar në fjalinë e fundit të pikës dy të kërkesës.
- 7.3. *E drejta për kompensim të drejtë*, pasi KEDNJ-ja ka epërsi ndaj Ligjit Organik të Gjykatës dhe kërkuesit i janë cenuar haptazi të drejtat e parashikuara nga nenet 2, pika 2, 3, 6, pika 1, 8, pika 1, 13, 14 dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj. Gjykata, në vendimit e cituara në pikën tre të objektit të kërkesës, nuk mund të justifikohet me nenin 80 të Ligjit Organik të saj, duke anashkaluar dispozitat e KEDNJ-së, për më tepër kur ato vendime nuk janë botuar në Fletoren Zyrtare. Po kështu, Gjykata nuk ka të drejtë të shfuqizojë ligjin e kohës, mbi bazën e të cilit kërkuesi ka fituar të drejtën e bashkëpronësisë.
- 7.4. *Standardi në gjykimin penal*, pasi asnjëra nga gjykatat nuk është fokusuar në shkeljet që kanë bërë subjektet e kallëzuar. Nuk ka ligj që parashikon pranimin e dhunimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë të lëna në fuqi nga Gjykata e Lartë. Cenimi i nenit 451/a të Kodit të Procedurës Civile është edhe cenim i nenit 81, pika 2, shkronja “d”, të Kushtetutës si nga personat e kallëzuar, ashtu edhe nga organi i akuzës dhe gjykatat. Kjo përbën edhe cenim të shtetit të së drejtës.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuarit

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Kriteret paraprake të legjitimitimit janë të natyrës kumulative, ndaj, në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuari të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Kolegji evidenton se gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitimit, në varësi të elementeve dhe veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë dhe shterues për kërkuarin. Thënë ndryshe, mund të ndodhë që në shqyrtimin paraprak të një çështjeje të verifikohet mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, duke sjellë, si pasojë, moskallimin e saj në seancë plenare.

10. Në kuptim të sa më sipër, në vlerësimin paraprak të respektimit të kriterëve të legjitimitimit për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues, në drejtim të pretendimeve të parashtruara nga kërkuari në mbështetje të ankimit kushtetues individual, Kolegji vëren se pretendimet e kërkuarit në përmbajtje të ankimit kushtetues, në lidhje me vendimet gjyqësore të kundërshtuara, kanë të bëjnë, në thelb, me të drejtën e pronës private që, sipas tij, është cenuar për shkak të veprimeve e të mosveprimeve të kryera nga personat e kallëzuar prej tij. Sipas kërkuarit, shtetasi E.K., gjatë ushtrimit të detyrës, ka urdhëruar shkatërrimin e pronës së tij dhe veprimet e kundërligjshme të atij janë mbrojtur nga prokurorët e çështjes. Në këtë mënyrë, kërkuari, edhe pse ka kundërshtuar mosfillimin (pushimin) e procedimit penal për personat e kallëzuar prej tij, në thelb, kërkon mbrojtjen e së drejtës së pronës private, duke synuar ardhjen e pasojave pikërisht në këtë të drejtë substanciale, që ka qenë edhe objekt i

proceseve të tjera gjyqësore civile, në të cilat kërkuesi ka pasur si cilësinë e paditësit, ashtu edhe të të paditurit.

11. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se kërkuesi ka ushtruar lirisht mjetet juridike në dispozicion për kundërshtimin në gjykatë të vendimit të prokurorit për mosfillimin (pushimin) e procedimit penal dhe në vijim edhe për kundërshtimin e vendimeve gjyqësore që kanë rrëzuar ankimet e tij si të pabazuara. Gjykatat e faktit, pasi kanë marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuesit të parashtruara në ankimet drejtuar atyre, u kanë dhënë përgjigje të arsyetuara në lidhje me bazueshmërinë e tyre në ligj e në prova. Edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim pretendimet e parashtruara në rekurs, në përputhje me kompetencat e tij si gjykatë e ligjit dhe në përputhje me standardet e procesit të rregullt i ka dhënë përgjigje kërkuesit, duke arsyetuar qëndrimin e mbajtur në dispozitivin e vendimit. Arsyetimi i vendimeve objekt kërkese nuk duket të jetë haptazi arbitrar ose i paarsyeshëm, në kuptimin që të vërë në dyshim vetë të drejtën për një gjykim të drejtë. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuesit janë haptazi të pabazuara për sa kohë ai nuk ka mundur të argumentojë, në këndvështrimin kushtetues, cenimin e të drejtave të tij kushtetuese në procesin e kundërshtuar në ankimin kushtetues individual për shkak të mënyrës sesi janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga prokuroria kallëzimet e tij dhe, në vijim, për shkak të rrëzimit të ankimeve të tij nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Për këto arsye, Kolegji konstaton se pretendimet e kërkuesit të paraqitura me ankimin kushtetues individual objekt shqyrtimi nuk e plotësojnë kriterin *ratione materiae*.

12. Në këndvështrim të sa më lart, për shkak të karakterit kumulativ të tyre, Kolegji evidenton se nuk është e nevojshme analizimi i mëtejshëm i plotësimit të kriterëve të tjera të legjitimitetit të ankimit kushtetues të individual të kërkuesit.

13. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuesit nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.